



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA E TIRANË**  
**AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT**

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË**  
**MARRËVESHJEN KUADËR**  
**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

**Drejtuar:** Operatorit ekonomik “A I b G a r d e n” Shpk

**Adresa:** Rruga e Kavajes, ish Misto Mame, Zona Kadastrale 8240, Tiranë

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar / Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara.**

Numri i procedurës: **NR.REF-16782-08-21-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Blerje drurë dhe shkurre dekorative”**

Publikimet e mëparshme (*nëse është rasti*): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr.54, datë 26 Gusht 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. “AGRO-KORANI” Shpk**

**NIPT-t: L13329801V**

Vlera e ofertës: **43.753.000** (dyzetë e tremilion e shtatëqind e pesëdhjetë e tremijë) lekë pa Tvsh

**2. “Gjelbërimi 2000” Shpk**

**NIPT-t : L21513012D**

Vlera e ofertës: **43.888.000** (dyzetë e tremilion e tetëqind e tetëdhjetë e tetëmijë) lekë pa Tvsh

**3. “A I b G a r d e n” Shpk**

**NIPT-t : K37513520N**

Vlera e ofertës: **56.400.000** (pesëdhjetë e gjashtëmilion e katërqindmijë) lekë pa Tvsh

#### 4. “FLORAL” Shpk

NIPT-t : L21513012D

Vlera e ofertës: **57.775.000** (pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë pa Tvsh

**Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:**

#### 1. “AGRO-KORANI” Shpk

NIPT-t: L13329801V

Vlera e ofertës: **43.753.000** (dyzetë e tremilion e shtatëqind e pesëdhjetë e tremijë) lekë pa Tvsh

#### *arsyet e mëposhtme*

a) *Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.8 përcaktohet sa më poshtë:*

**2.3.8** *Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloge ose broshura për mallin që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e kuotuar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet sipas shtojces 5 sipas të dhënave në DST. (Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të modelit të kuotuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmerinë e tyre). (Pjesa e katalogut që përfshin specifikimet teknike të jete e perkthyer).*

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i katalogut të prodhuesit “Innocenti & Mangoni piante” paraqitur nga operatori ekonomik “Agrokorani” shpk karakteristikat teknike për artikujt Nr.13 “Panjë gjethe rrap” dhe Nr.14 “Ligustër”, “Ligustrum vulgare” janë në gjuhën e origjinës italiane dhe të papërkthyer në gjuhën shqipe apo angleze sikundër përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në nenin 40 “Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në udhëzimet për operatorët ekonomikë përcaktohet në Seksionin 1 Udhëzime për operatorët ekonomikë, Seksioni B “Pergatitja e ofertave” pika 2 “Gjuha e ofertes” përcaktohet me poshtë :

*Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.*

## Në shtojcën Njoftimi i kontratës, Seksioni 4: Procedura është përcaktuar

### Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

**Shqip**

**X**

**Anglisht**

**X**

Në katalogun sa më sipër për zërin ligustrum ka një përkthim në gjuhët e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe gjithashtu katalogu nuk është i shoqëruar në tërësinë e tij nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim.

Nga verifikimi i katalogut të paraqitur nga operatori ekonomik “Agrokorani” shpk dhe krahasimi i specifikimeve teknike të paraqitura në katalog me specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit konstatohet sa më poshtë:

- Për llojin e drurit Man (Morus Alba Pendula) ne karakteristikat teknike të përcaktuara sipas katalogut eshte plotësuar kriteri për cirkoferencen 14-16 por nuk ka asnjë të dhënë për lartesine totale te llojit të drurit Man të ofertuar sikundër është kërkuar nga autoriteti kontraktor ne specifikimet teknike.

- Për llojin e drurit Verri (Alnus glutinosa) ne karakteristikat teknike të përcaktuara sipas katalogut nuk plotësohet kriteri për cirkoferencen 16-18 pasi cirkoferenca maksimale e deklaruar në katalog është 14-16 dhe gjithashtu në katalog nuk ka asnjë të dhënë për lartesine totale te llojit të drurit Verri të ofertuar sikundër është kërkuar nga autoriteti kontraktor ne specifikimet teknike.

- Për llojin e drurit Rrap (Platanus Orientalis) ne karakteristikat teknike të përcaktuara sipas katalogut eshte plotësuar kriteri për cirkoferencen 16-18 por nuk ka asnjë të dhënë për lartesine totale te llojit të drurit Rrap të ofertuar sikundër është kërkuar nga autoriteti kontraktor ne specifikimet teknike.

- Për llojin e drurit Likuidamber (Liquidamber styraciflua) ne karakteristikat teknike të përcaktuara sipas katalogut eshte plotësuar kriteri për cirkoferencen 16-18 por nuk plotëson lartesine totale te llojit të drurit Likuidambër 300-400 cm sikundër është kërkuar nga autoriteti kontraktor ne specifikimet teknike.

- Për llojin e drurit Sofora (Sofora Japonica) ne karakteristikat teknike të përcaktuara sipas katalogut eshte plotësuar kriteri për cirkoferencen 20-25 por nuk plotëson lartesine totale te llojit të drurit Sofora Japonica 300-400 cm sikundër është kërkuar nga autoriteti kontraktor ne specifikimet teknike.

- Për llojin e drurit Ligustrum ne karakteristikat teknike të përcaktuara sipas katalogut eshte plotësuar kriteri për cirkoferencen 20-25 por nuk plotëson lartesine totale te llojit të drurit Sofora Japonica 300-400 cm sikundër është kërkuar nga autoriteti kontraktor ne specifikimet teknike.

- Për llojin e drurit Bli (Tilia Argentata) ne karakteristikat teknike të përcaktuara sipas katalogut eshte plotësuar kriteri për cirkoferencen 25-30 por nuk ka asnjë të dhënë për lartesine

totale te llojit të drurit Bli (Tilia Argentata) të ofertuar sikundër është kërkuar nga autoriteti kontraktor ne specififikimet teknike.

- Për llojin e drurit Rrap (Platanus Orientalis) ne karakteristikat teknike të përcaktuara sipas katalogut eshte plotësuar kriteri për cirkoferencen 25-30 por nuk ka asnjë të dhënë për lartesine totale te llojit të drurit Rrap (Platanus Orientalis) të ofertuar sikundër është kërkuar nga autoriteti kontraktor ne specififikimet teknike.

a) *Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”,Kapaciteti teknik 2.3, pika 2.3.9, përcaktohet se:* Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me makinerite/pajisjet që disponon sipas formatit të mëposhtëm:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Kamionçinë me vinç, masa maksimale jo me shume 3.5 ton .</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>2 Copë</i>
<i>2</i>	<i>Kamionçinë , masa maksimale jo me shume 3.5 ton .</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>3 Copë</i>
<i>3</i>	<i>Kamion me vinç,(kapaciteti mbajtës minimum 6 ton dhe maksimumi 11 ton ) .</i>	<i>Pronësi ose me qira</i>	<i>2 Copë</i>

Per kete operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).

- Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik ( e vlefshme ), d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).

*\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Sa më sipër përcaktuar në dokumentat e tenderit si dhe në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Neni 26, pika 7 në këtë fazë të vlerësimit procedural me qëllim marrjen e një vendimi sa më të plotë dhe të saktë mbi përputhshmërinë e tipologjisë dhe kapaciteteve të këtyre mjeteve me tipologjinë dhe kapacitetet e kërkuara nga autoriteti kontraktor komisioni i vlerësimit të ofertave ka kërkuar nga institucionët

shtetërore “Drejtoritë e Transportit Rrugor” përkatëse informacion në lidhje me mjetet për të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit i është drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Durrës me anë të shkresës Nr.1825/4, datë 30.09.2024 “Kërkesë për informacion” dhe ka marrë përgjigje me anë të shkresës Nr.2246/1, datë 03.10.2024 “Kthim përgjigje” në të cilën specifikohet lloji i mjeteve destinacioni i tyre kodi i karrocërisë etj.

***Në plotësim të kriterit për makineritë operatori ekonomik “Agrokorani ” shpk ka deklaruar në shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” mjetet sa më poshtë:***

Pershkrimi i mjetit	Pronesi/Qera	Targa	Nr.Shasisë
Kamioncin me vinc me kapacitet mbajtes 1.54 ton	AGRO-KORANI	AA765EN (AB 765EN)	WDB9062551N310637
Kamion me kapacitet mbajtes 3.4 ton me vinc	AGRO-KORANI	AA795KB	WDB0720211K443935
Kamioncinë ( Masa maksimale 3.5 ton )	AGRO-KORANI	AA644LB	WDB9061551N312457
Kamioncin ( Masa maksimale 3.5 ton )	AGRO-KORANI	AA455RK	WDB9062531N20295
Kamioncinë ( Masa maksimale 2.65 ton )	AGRO-KORANI	AA578BD	WDB6013121P044038
<b>Me qera</b>			
Kamion me vinc ( kapacitet mbajtes 8 ton )	GECI	AA146PO	WMAF041193M131750
Kamion me vinc ( kapacitet mbajtes 6.94 ton )	GECI	AA163RT	WMAH80ZZ26M428170
Kamioncinë me vinc	Vehbi Bicaku	AA326KF (AA362KF)	WDB611471P354291
Kamioncinë me vinc	Valmira Topalli	AA068MY	ZCFC3591005348804

Nga verifikimi i informacionit të disponuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka konstatuar sa më poshtë vijon:

- Mjeti me targa AA 765 EN i deklaruar ne formularin permbledhes te vetdeklarimit “Kamioncinë me vinc me kapacitet mbajtës 1.54 ton” nuk ka perputhje me numrin e shasisë se deklaruar dhe nuk është mjet në pronësi të shoqërisë “Agrokorani” shpk sikunder deklaruar por rezulton në pronësi të Alketa Veli Dedja dhe Zaudin Jaho Borici.

Numri i shasisë së deklaruar për këtë mjet ne formularin përmbledhës të vetdeklarimit i korrespondon mjetit me targa AB 765 EN në pronësi të shoqërisë “Agrokorani” me mase maksimale 5000 ton dhe kapacitet mbajtes 1.54 ton i cili nuk korrespondon me asnje nga kapacitetet e mjeteve të kerkuara nga autoriteti kontraktor.

Pra për mjetin sa më sipër deklarimi nuk është bërë i saktë në formularin përmbledhës të vetdeklarimit dhe gjithashtu kapaciteti i ketij mjeti nuk përputhet me asnjë nga kapacitetet e kerkuara nga autoriteti kontraktor.

Në vijimesi te ketij arsyetimi Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson se mjeti nuk është paraqitur konform kërkesës së Autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i rregullt.

- Mjeti me targa AA795KB i deklaruar ne formularin permbledhes te vetdeklarimit si Kamion me kapacitet mbajtës 3.4 ton me vinç” mjet në pronësi ka masë maksimale 7490 kg dhe kapacitet mbajtes 3.34 ton është me kodin e karrocërisë E 7 “kamion me vinc” sikunder kërkuar por referuar kapaciteteve nuk korrespondon me asnjë nga kapacitetet e mjeteve të kerkuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor.

Në vijimesi te ketij arsyetimi Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson se mjeti nuk është paraqitur konform kërkesës së Autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i rregullt.

- Mjeti me targa AA644 LB i deklaruar ne formularin permbledhes te vetdeklarimit si “Kamioncinë masa maksimale 3.5 ton” mjet në pronësi kodin e karrocërisë referohet DK- Furgon i larte ka masen maksimale 3500 kg pra konsiderohet ne perputhje me kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në piken 2.3.9/2 (*Kamioncinë , masa maksimale jo me shume 3.5 ton*)

- Mjeti me targa AA455 RK i deklaruar ne formularin permbledhes te vetdeklarimit si “Kamioncinë masa maksimale 3.5 ton” mjet ne pronesi, kodin e karrocërisë referohet kod karrocërie BA-e mbyllyr me 4 dyer masa maksimale 3500 kg pra konsiderohet ne perputhje me kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në piken 2.3.9/2 (*Kamioncinë , masa maksimale jo me shume 3.5 ton*).

- Mjeti me targa AA578BD i deklaruar ne formularin permbledhes te vetdeklarimit si “Kamioncinë masa maksimale 2.65 ton” mjet ne pronesi ka masen maksimale 2650 kg dhe kodin e karrocërisë referohet kod karrocërie DD-Furgon me dere anesore pra konsiderohet ne perputhje me kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në piken 2.3.9/2 (*Kamioncinë , masa maksimale jo me shume 3.5 ton*)

- Mjeti me targa AA 146 PO i deklaruar ne formularin permbledhes te vetdeklarimit nga shoqëria “Agrokorani” si mjet i marrë me qera, mjeti në pronesi te shoqërisë Geci shpk si “Kamion me vinç (kapaciteti mbajtës 8 Ton). Në informacionin e dhënë në skedën teknike te mjetit konstatohet që mjetit i referohet kod karrocërie KL-Germues pra nuk është kamion me vinc sikunder deklaruar dhe ne destinacionin e Mjetit përshkruhet Mjet për perdorim vetiak-Përdorim vetjak.

Ne formularin permbledhes te vetdeklarimit eshte deklaruar se mjeti eshte marre me qera nga shoqëria Geci shpk.

Referuar Ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së shqipërisë”, i ndryshuar, Pjesa II, Neni 81 “Destinacioni dhe perdorimi i mjeteve” pikat 1,2,3,4,5 dhe 7,8 percaktohet sa me poshte:

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.
  2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik.
  3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.
  4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.
  5. Përdorimi nga të tretët përfshin: a) dhënien me qira pa drejtues mjeti; b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish; c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh; d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve; e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave; f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të tretëve
- Pra sa me sipër ligjvënisi ka percaktuar se në rastet kur mjeti jepet me qera në lejen e qarkullimit destinacioni i mjetit duhet të jete e percaktuar që mjeti të jepet për përdorim nga të tretët. Në të gjitha rastet e tjera mjeti është për përdorim vetjak dhe nuk mund të përdoret nga persona të tjera të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit kundrejt pagesës. Në të tilla raste ligjvënisi në pikën 8 percakton sanksione, ku specifikisht sipas pikës 8, citohet:

*“.....cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë..”*

Sa më sipër argumentuar mjeti me targa AA 146 PO referuar kodit të karrocierisë nuk është kamion me vinq sikundër deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit dhe gjithashtu është mjet për përdorim vetjak dhe referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi nuk lejohet përdorimi i tij nga persona të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit, i cili e përdor mjetin vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në vijimesi të këtij gjykimi Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson se mjeti nuk është paraqitur konform kërkesës së Autoritetit kontraktor.

- Mjeti me targa AA 163 RT i deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit nga shoqëria “Agrokorani” si mjet i marrë me qera, mjeti në pronësi të shoqërisë Geci shpk, “Kamion me vinq (kapaciteti mbajtës 6.94 Ton). Në informacionin e dhënë në skedën teknike të mjetit konstatohet që mjeti i referohet kod karrocierie KL-Germues pra nuk është kamion me vinq sikundër deklaruar dhe në destinacionin e Mjetit përshkruhet Mjet për përdorim vetjak-Përdorim vetjak.

Në formularin përmbledhës të vetdeklarimit është deklaruar se mjeti është marrë me qera.

Në lidhje me këtë mjet kod i karrocierisë nuk përputhet me deklarimin e mjetit si kamion me vinq dhe gjithashtu sa më sipër arsyetuar mjeti është për përdorim vetjak është në emër të shoqërisë Geci shpk, dhe përdorimi i tij nga persona të tretë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit dhe në rastin konkret nga shoqëria “Agrokorani” do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

Në vijimesi të këtij gjykimi Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson se mjeti nuk është paraqitur konform kërkesës së Autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i rregullt.

- Mjeti me targa AA 326 KF i deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit nga shoqëria “Agrokorani” si mjet i marrë me qera, muet në pronësi të Vehbi Bicaku person fizik, “Kamioncine me vinq” ka të deklaruar gabim targën në formularin përmbledhës të vetdeklarimit pasi është deklaruar mjet me targa AA 326 KF ndërkohe nga verifikimi i skedes teknike të mjetit rezulton se numrit të shasisë së deklaruar i korrespondon mjeti me targa AA 362 KF. Mjeti është deklaruar kamionçinë me vinq ndërkohe kod i karrocierisë është D2- Furgone vetshkarkues me masë maksimale 3500 kg pra nuk referohet në skedë teknike vinqi. Destinacioni i mjetit

është për përdorim vetiak, dhe përdorimi i tij nga persona të tretë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit dhe në rastin konkret nga shoqëria “Agrokorani” do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

Në vijimesi të këtij gjykimi Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson se mjete nuk është paraqitur konform kërkesës së Autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i rregullt.

- Mjeti me targa AA 068 MY i deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit nga shoqëria “Agrokorani” si mjet i marrë me qera, mjet në pronësi të Valmira Qemal Topalli. Mjeti është deklaruar “Kamionçinë me vinc” nderkohe kodi i karrocërës është B8- e mbyllur me 2 dyer me masë maksimale 3500 kg pra nuk ka përputhje me përshkrimin e bërë në formularin përmbledhës të vetdeklarimit ku është deklaruar kamioncine me vinc nuk referohet në skedën teknike që mjeti është me vinc. Destinacioni i mjetit është për përdorim vetiak, dhe përdorimi i tij nga persona të tretë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit dhe në rastin konkret nga shoqëria “Agrokorani” do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

Në vijimesi të këtij gjykimi Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson se mjeti nuk është paraqitur konform kërkesës së Autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i rregullt.

Në tërësinë e verifikimit të mjeteve të deklaruara referuar informacionit të disponuar konstatohet se operatori ekonomik “Agrokorani” shpik nuk plotëson kriterin përcaktuar sipas pikës 2.3.9 për pikën 1 ku kërkohen “*Kamionçinë me vinc, masa maksimale jo më shumë 3.5 ton*” *copë 2 pasi asnjë nga mjetet e deklaruara në plotësim të këtij kriteri nuk është i rregullt dhe gjithashtu nuk ka deklaruar asnjë mjet të rregullt dhe në plotësim të pikës 2.3.9, pika 3 Kamion me vinc, (kapaciteti mbajtës minimum 6 ton dhe maksimumi 11 ton ) 2 cope.*

Sa më sipër Komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon se operatori ekonomik “Agrokorani” shpik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit Kriteret e Veçanta për kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.9 pasi janë konstatuar mospërputhje të skedës teknike të mjetit me deklaratat e bëra si dhe ka patur probleme me përdorimin e ligjshëm të disa prej tyre, duke përjashtuar kështu mundësinë për t'u konsideruar të rregullta nga Komisioni i vlerësimit të ofertave.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar



shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “**AGRO-KORANI**” Shpk nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

## 2. “Gjelbërimi 2000” Shpk

NIPT-t : L21513012D

Vlera e ofertës: **43.888.000** (dyzetë e tremilion e tetëqind e tetëdhjetë e tetëmijë) lekë pa Tvsh

### *arsyet e mëposhtme:*

#### *a) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.7 përcaktohet sa më poshtë:*

**2.3.7** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmë të testimeve zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi:

- Çertifikate zyrtare model 3, te aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit, sipas modelit 4, të aneksit 4 dhe certifikate origjinë të leshuara nga Enti Shtetror i farnave e fidanave sipas VKM Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative) *ose* Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë furnizimi me një subjekt që duhet të jetë i pajisur me Certifikate zyrtare model 3 te aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit sipas modelit 4 te aneksit 4 dhe certifikate origjine të leshuara nga Enti Shtetëror i farnave e fidanave sipas VKM vendim Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative)

*ose*

- Në rastin kur furnizimi do të bëhet nga një prodhues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë operatori ekonomik duhet të paraqesë një autorizim prodhuesi/distributori për furnizimin nga subjekti importues ku duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, shoqëruar me një deklaratë (nga subjekti importues) që në momentin e furnizimit me druret dhe shkurret

dekorative (sipas sasise dhe specifikimeve teknike ) do shoqerohen me “ Çertifikate Fitosanitare “ nga shteti importues , e cila verteton pastertine gjenetike të bimes .

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Gjelberimi 2000”shpk & “I.D.K- Konstruksion”shpk konstatohet se në plotësim të këtij kriteri operatori ekonomik “Gjelberimi 2000” shpk ka paraqitur Çertifikaten zyrtare Nr.006 për të gjithë zërat e preventivit ndërkohë që referuar kontratës së bashkepunimit ky operator ekonomik do të furnizojë vetëm 89.7 % të kontratës dhe 10.3 % të kësaj kontrate do ta furnizojë operatori tjetër anëtar i këtij bashkimi “I.D.K- Konstruksion”shpk i cili për zërat që ka marrë përsipër të furnizojë sipas preventivit nuk ka paraqitur dëshmi të testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuara apo nga prodhuesi. Nuk ka asnjë dokument provues që ky operator ekonomik disponon këto dëshmi apo do të furnizojë këtë produkt nga një prodhues i caktuar.

Sikundër arsyetuar dhe argumentuar dhe në pikën më sipër komisioni i vlerësimit të ofertave gjykon, se qëllimi i shprehur qartësisht në nenin 88 pika 3 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është që secili nga operatorët e bashkimit të mund të zotërojë kapacitete ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të zërave për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes, bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomik, gjykojmë, se anëtari i bashkimit “IDK-Konstruksion” shpk, ka marrë përsipër furnizimin me drurë për 3(tre) zëra të preventivit dhe nuk ka paraqitur certifikatat zyrtare për bimët që do të furnizojë si dhe nuk ka asnjë dokument provues që këto bimë do të furnizohen nga një prodhues i caktuar i cili të justifikojë paraqitjen e certifikatës nga operatori ekonomik “Gjelberimi 2000” shpk për të gjitha bimët në tërësi.

Sa më sipër Bashkimi i operatorëve ekonomik “Gjelberimi 2000” shpk & “I.D.K- Konstruksion” shpk nuk plotëson kriterin përcaktuar nga Autoriteti kontraktor në Kriteret e vecanta për kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.7

***b) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik” pika 2.3.8 përcaktohet sa më poshtë:***

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloge ose broshura për mallin që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e kuotuar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet sipas shtojces 5 sipas të dhënave në DST. (Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të modelit të kuotuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmerinë e tyre).(Pjesa e katalogut që përfaqëson specifikimet teknike të jete e perkthyer).

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Gjelberimi 2000”shpk & “I.D.K- Konstruksion”shpk konstatohet se operatori ekonomik “Gjelberimi

2000”shpk ka paraqitur Katalogun për të gjithë zërat e preventivit nderkohë që referuar kontratës së bashkëpunimit ky operator ekonomik do të furnizojë vetëm 89.7 % të kontratës dhe 10.3 % të kësaj kontrate do ta furnizojë operatori tjetër anëtar i këtij bashkimi i cili për zërat që ka marrë përsipër të furnizojë sipas preventivit nuk ka paraqitur katalogun. Nuk ka asnjë dokument provues që ky operator ekonomik do të furnizojë këto produkte nga operatori tjetër ekonomik anëtar i këtij bashkimi. Secili nga operoret ekonomikë pjesë të këtij bashkimi ka marrë përsipër të furnizojë zera specifik sipas preventivit të ndarjes së zërave në kontratën e bashkëpunimit duke mos cilësuar në asnjë pikë të kontratës së bashkëpunimit se furnizimi do të bëhet vetëm nga operatori ekonomik “Gjelberimi 2000” shpk dhe duke mos disponuar asnjë dokumentacion tjetër provues se operatori ekonomik “I.D.K- Konstruksion” shpk do ti furnizojë produktet e deklaruara në procedurë për pjesën përkatëse nga operatori ekonomik “Gjelberimi 2000” shpk

Sa më sipër Bashkimi i operatorëve ekonomik “Gjelberimi 2000” shpk & “I.D.K- Konstruksion” shpk nuk plotëson kriterin përcaktuar nga Autoriteti kontraktor në Kriteret e vecanta për kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.8

- c) *Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, Kapaciteti teknik 2.3, pika 2.3.9, përcaktohet se:* Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me makinerite/pajisjet që disponon sipas formatit të mëposhtëm:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Kamionçinë me vinç, masa maksimale jo me shume 3.5 ton .</i>	Pronësi ose me qira	2 Copë
2	<i>Kamionçinë , masa maksimale jo me shume 3.5 ton .</i>	Pronësi ose me qira	3 Copë
3	<i>Kamion me vinç,(kapaciteti mbajtës minimum 6 ton dhe maksimumi 11 ton ) .</i>	Pronësi ose me qira	2 Copë

Per kete operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik ( e vlefshme ), d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).

*\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Sa më sipër përcaktuar në dokumentat e tenderit si dhe në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar Neni 26, pika 7 në këtë fazë të vlerësimit procedural me qëllim marrjen e një vendimi sa më të plotë dhe të saktë mbi përputhshmërinë e tipologjisë dhe kapaciteteve të këtyre mjeteve me tipologjinë dhe kapacitetet e kërkuara nga autoriteti kontraktor komisioni i vlerësimit të ofertave ka kërkuar nga institucionet shtetërore Drejtorite e Transportit Rrugor informacion në lidhje me mjetet për të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Autoriteti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit i është drejtuar Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor Tirane me anë të shkresës Nr.1825/6, datë 30.09.2024 “Kërkesë për informacion” dhe ka marrë përgjigje me anë të shkresës Nr.47195/1, datë 08.10.2024 “Kthim përgjigje në të cilën specifikohet lloji i mjeteve destinacioni i tyre kodi i karrocise etj.

***Në plotësim të kriterit për makineritë bashkimi i operatorëve ekonomik “Gjelberimi 2000” shpk & “I.D.K-Konstruksion” shpk kane deklaruar në shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” mjetet sa më poshtë:***

Kamionçinë me vinç, kapaciteti jo me shume 3.5 ton	Sirieta F	AA698MZ	ZCFA7580002130537
Kamionçinë me kapaciteti jo me shume 3.5 ton	Sirieta F	AA791GK	ZCFA75A0002132608
Kamionçine masa maksimale jo me shume se 3.5 ton	Sirieta F	AB917LB	MMBJNK740D020165
Kamion me vinç,(kapaciteti mbajtës minimum 6 ton	Sirieta F	AA 798 CP	WDB61631515461007
Kamionçine masa maksimale jo me shume se 3.5 ton	I.D.K	AA413UZ	WDB9091531N451050
Kamionçine masa maksimale jo me shume se 3.5 ton	I.D.K	AA071RE	WDB9046231R348965
Kamionçine masa maksimale jo me shume se 3.5 ton	I.D.K	AA625PY	WDB9046221R110112
Kamion me vinç, ( kapaciteti mbajtes minimumi 6 ton maksimumi 11 ton )	I.D.K	AB148OI	WDB9702781L477968
Kamionçinë me vinç, masa maksimale jo me shume 3.5 ton	GJELBERIMI 2000	AA723TH	ZCFC65D0005764840

Kamionçinë me vinç, masa maksimale jo me shume 3.5 ton	Qera ( Flamur Kera )	TR6268R	ACFC355010Z006573
Kamion me vinc kap mbajtes 6-11 ton	Qera ( Besnik Hajdini )	AB405BD	XLRAE55CF0L237908
Kamionçine masa maksimale jo me shume se 3.5 ton	Qera ( KUPA )	AA816OR	AHTKB3CB302360453
Kamionçine masa maksimale jo me shume se 3.5 ton	Qera ( KUPA )	AA864OV	AHTHB3CC002012712
Kamionçine masa maksimale jo me shume se 3.5 ton	Qera ( KUPA )	AA761OR	AHTHB3CC002012922

Me verifikimin e informacionit të disponuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka konstatuar sa vijon:

- Mjeti me targa AA 698 MZ i deklaruar ne formularin permbledhes te vetdeklarimit “Kamioncine me vinc jo me shume se 3.5 ton” nga shoqëria “Sireta 2 F” shpk në rolin mbështetës i operatorit ekonomik “Gjelbërimi 2000” shpk ka kodin e karrocërisë E 7 “Kamion me vinc i montuar pas gabinës” por ka mase maksimale 7500 dhe kapacitet mbajtes 3.1 ton pra referuar kapaciteteve nuk korrespondon me asnjë nga kapacitetet e mjeteve të kërkuara ne dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor ne pikat 2.3.9/1 *Kamionçinë me vinç, masa maksimale jo me shume 3.5 ton dhe 2.3.9/3 Kamion me vinç,(kapaciteti mbajtës minimum 6 ton dhe maksimumi 11 ton )* .

Në vijimesi te këtij gjykimi Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson se mjeti nuk është paraqitur konform kërkesës së Autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i rregullt.

- Mjeti me targa AA 791GK i deklaruar ne formularin permbledhes te vetdeklarimit “Kamioncine me kapacitet mbajtes deri ne 3.5 ton” nga shoqëria “Sireta 2 F” shpk në rolin mbështetës i operatorit ekonomik “Gjelbërimi 2000” shpk. Nga informacioni i dhene ne skeden teknike te mjetit konstatohet qe eshte me kod karrocërie KL-Germues pra nuk është kamioncine apo kamion dhe ka mase maksimale 7500 dhe kapacitet mbajtes 2110 kg pra referuar kapaciteteve nuk korrespondon me asnjë nga kapacitetet e mjeteve të kërkuara kamion me vinc ne dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor ne pikat 2.3.9/1 *Kamionçinë me vinç, masa maksimale jo me shume 3.5 ton dhe 2.3.9/3 Kamion me vinç,(kapaciteti mbajtës minimum 6 ton dhe maksimumi 11 ton )* .

Sa më sipër argumentuar mjeti me targa AA 791GK referuar kodit të karrocërisë nuk është kamioncine sikundër deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit dhe gjithashtu nuk ploteson kapacitetet sikunder percaktuar nga autoriteti kontraktor.

Në vijimesi te këtij gjykimi Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson se mjeti nuk është paraqitur konform kërkesës së Autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i rregullt.

- Mjeti me targa AA 917 LB i deklaruar ne formularin permbledhes te vetdeklarimit “Kamioncine masa maksimale jo me shume se 3.5 ton” nga shoqëria “Sireta 2 F” shpk në rolin

mbështetës i operatorit ekonomik “Gjelbërimi 2000” shpk ka masen maksimale 3500 kg dhe kodi i karrocierise referohet kod karrocierie B2-e Hapur pra konsiderohet ne perputhje me piken 2.3.9/2 (*Kamionçinë , masa maksimale jo me shume 3.5 ton*).

- Mjeti me targa AA798 CP i deklaruar ne formularin permbledhes te vetdeklarimit “Kamionme vinc (kapaciteti mbajtes minimumi 6 ton)” nga shoqëria “Sireta 2 F” shpk në rolin mbështetës i operatorit ekonomik “Gjelbërimi 2000” shpk ka kapacitet mbajtes 6650 kg dhe kodi i karrocierise referohet F 8- kamion me vinc pra konsiderohet ne perputhje me piken 2.3.9/3 (*Kamion me vinc,(kapaciteti mbajtes minimum 6 ton dhe maksimumi 11 ton )*).
- Mjeti me targa AA 413UZ i deklaruar ne formularin permbledhes te vetdeklarimit si mjet ne pronesi të shoqërisë “I.D.K- Konstruksion ka masen maksimale 3500 kg dhe kodi i karrocierise referohet kod karrocierie B2-e Hapur pra konsiderohet ne perputhje me piken 2.3.9/2 (*Kamionçinë , masa maksimale jo me shume 3.5 ton*).
- Mjeti me targa AA 071RE i deklaruar ne formularin permbledhes te vetdeklarimit si mjet ne pronesi të shoqërisë “I.D.K- Konstruksion ka masen maksimale 3500 kg dhe kodi i karrocierise referohet kod karrocierie B2-e Hapur pra konsiderohet ne perputhje me piken 2.3.9/2 (*Kamionçinë , masa maksimale jo me shume 3.5 ton*).
- Mjeti me targa AA 625 PY i deklaruar ne formularin permbledhes te vetdeklarimit si mjet ne pronesi të shoqërisë “I.D.K- Konstruksion ka masen maksimale 3500 kg dhe kodi i karrocierise referohet kod karrocierie B2-e Hapur pra konsiderohet ne perputhje me piken 2.3.9/2 (*Kamionçinë , masa maksimale jo me shume 3.5 ton*).
- Mjeti me targa AB 148OI i deklaruar ne formularin permbledhes te vetdeklarimit si mjet ne pronesi të shoqërisë “I.D.K- Konstruksion ka kapacitet mbajtes 6650 kg dhe kodi i karrocierise referohet F 8- kamion me vinc pra konsiderohet ne perputhje me piken 2.3.9/3 (*Kamion me vinc,(kapaciteti mbajtes minimum 6 ton dhe maksimumi 11 ton )*).
- Mjeti me targa AA723 TH i deklaruar ne formularin permbledhes te vetdeklarimit si “Kamionçinë me vinc, masa maksimale jo me shume 3.5 ton” mjet ne pronesi të shoqërisë “Gjelbërimi 2000” shpk me kod karrocierie F8-kamion me vinc ka masen maksimale 6300 kg dhe kapacitetin mbajtes 2500 kg pra referuar kapaciteteve nuk korrespondon me deklarimin e bere nga operatori ekonomik ne formularin përmbledhes të vetdeklarimit dhe gjithashtu nuk korrespondon me asnjë nga kapacitetet e mjeteve të kërkuara kamioncine apo kamion me vinc ne dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor ne pikat 2.3.9/1 *Kamionçinë me vinc, masa maksimale jo me shume 3.5 ton dhe 2.3.9/3 Kamion me vinc,(kapaciteti mbajtes minimum 6 ton dhe maksimumi 11 ton )*

Në vijimesi te këtij gjykimi Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson se mjeti nuk është paraqitur konform kërkesës së Autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i rregullt.

- Mjeti me targa TR 6268R i deklaruar ne formularin permbledhes te vetdeklarimit si “Kamionçinë me vinc, masa maksimale jo me shume 3.5 ton” ne pronesi te personit fizik Flamur Kera shpk i deklaruar me qera nga shoqëria “Gjelberimi 2000” shpk .Ne informacionin e dhene ne skeden teknike te mjetit konstatohet qe mjeti është me masë maksimale 3.5 ton por eshte me kod karrocierie B2-E hapur pra nuk është kamioncine me vinc pasi në skeden teknike nuk referohet vinci dhe gjithashtu ne destinacionin e Mjetit përshkruhet Mjet për perdorim vetiak-Përdorim vetjak.

Ne formularin permbledhes te vetdeklarimit eshte deklaruar se mjeti eshte marre me qera nga skeda teknike rezulton se mjeti me titullar leje qarkullimi Z.Flamur Kera.

Referuar Ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Pjesa II, Neni 81 “Destinacioni dhe përdorimi i mjeteve” pikat 1,2,3,4,5 dhe 7,8 përcaktohet sa më poshtë:

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.
2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik.
3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.
4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.
5. Përdorimi nga të tretët përfshin: a) dhënien me qira pa drejtues mjeti; b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish; c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh; d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve; e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave; f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të tretevePra sa më sipër ligjvënasi ka përcaktuar se në rastet kur mjeti jepet me qera në lejen e qarkullimit destinacioni i mjetit duhet të jetë e përcaktuar që mjeti të jepet për përdorim nga të tretët. Në të gjitha rastet e tjera mjeti është për përdorim vetjak dhe nuk mund të përdoret nga persona të tjera të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit kundrejt pagesës. Në të tilla raste ligjvënasi në pikën 8 përcakton sanksione, ku specifikisht sipas pikës 8, citohet:

*“.....cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë..”*

Sa më sipër argumentuar mjeti me targa TR 6268R referuar kodit të karrocërisë nuk është kamion me vinç sikundër deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit dhe gjithashtu është mjet për përdorim vetjak dhe referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi nuk lejohet përdorimi i tij nga persona të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit, i cili e përdor mjetin vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në vijimesi të këtij gjykimi Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson se mjeti nuk është paraqitur konform kërkesës së Autoritetit kontraktor.

- Mjeti me targa AB 405 BD i deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit “Kamion me vinc, kapaciteti mbajtës 6-11 ton” në pronësi të personit fizik Besnik Sule Hajdini shpk i deklaruar me qera nga shoqëria “Gjelberimi 2000” shpk . Nga skeda teknike e mjetit rezulton që mjeti ka kapacitet mbajtës 6640 kg dhe gjithashtu në skeden teknike të mjetit konstatohet që është me kod karrocërie FL-Kamion me vinc por në destinacionin e Mjetit përshkruhet Mjet për përdorim vetjak-Përdorim vetjak.

Në formularin përmbledhës të vetdeklarimit është deklaruar se mjeti është marrë me qera.

Në lidhje me këtë mjet konstatohet se mjeti është për përdorim vetjak në pronësi të personit fizik Besnik Sule Hajdini, dhe referuar akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi nuk lejohet përdorimi i tij nga persona të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit, i cili e përdor mjetin vetëm për llogari të veprimtarisë së vet.

Në vijimesi të këtij gjykimi Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson se mjeti nuk është paraqitur konform kërkesës së Autoritetit kontraktor.

- Mjeti me targa AA816OR i deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit “kamioncine masa maksimale jo më shumë se 3.5 ton” në pronësi të shoqërisë “KUPA” shpk i deklaruar me qera nga shoqëria “Gjelberimi 2000” shpk. Nga verifikimi i skedës teknike rezulton se mjeti ka masë maksimale 3080 dhe kod karrocërie B8 –E mbyllur me dy dyer por në destinacionin e Mjetit përshkruhet Mjet për përdorim vetjak-Përdorim vetjak.

Ne formularin permbledhes te vetdeklarimit eshte deklaruar se mjeteve eshte marre me qera.

Ne lidhje me kete mjet konstatohet se mjeteve është per perdorim vetiak ne pronesi te shoqërisë KUPA shpk, dhe përdorimi i tij nga persona të tretë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit dhe konkretisht nga shoqëria “Gjelberimi 2000” shpk i cili e deklaroi me qera do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

Në vijimesi te këtij gjykimi Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson se mjeteve nuk është paraqitur konform kërkesës së Autoritetit kontraktor dhe nu mund të konsiderohet i rregullt.

- Mjeteve me targa AA864OV i deklaruar ne formularin permbledhes te vetdeklarimit “kamioncine masa maksimale jo me shume se 3.5 ton” ne pronesi te shoqërisë “KUPA” shpk i deklaruar me qera nga shoqëria “Gjelberimi 2000” shpk. Nga verifikimi i skedës teknike rezulton se mjeteve ka mase maksimale 3150 kg dhe kod karrocierie BA –E mbyllur me 4 dyer por ne destinacionin e Mjetit përshkruhet Mjet për perdorim vetiak-Përdorim vetjak.

Ne formularin permbledhes te vetdeklarimit eshte deklaruar se mjeteve eshte marre me qera.

Ne lidhje me kete mjet konstatohet se mjeteve është per perdorim vetiak ne pronesi te shoqërisë KUPA shpk, dhe përdorimi i tij nga persona të tretë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit dhe konkretisht nga shoqëria “Gjelberimi 2000” shpk i cili e deklaroi me qera do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

Në vijimesi te këtij gjykimi Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson se mjeteve nuk është paraqitur konform kërkesës së Autoritetit kontraktor dhe nu mund të konsiderohet i rregullt.

- Mjeteve me targa AA761OR i deklaruar ne formularin permbledhes te vetdeklarimit “kamioncine masa maksimale jo me shume se 3.5 ton” ne pronesi te shoqërisë “KUPA” shpk i deklaruar me qera nga shoqëria “Gjelberimi 2000” shpk. Nga verifikimi i skedës teknike rezulton se mjeteve ka mase maksimale 3150 kg dhe kod karrocierie BA –E mbyllur me 4 dyer por ne destinacionin e Mjetit përshkruhet Mjet për perdorim vetiak-Përdorim vetjak.

Ne formularin permbledhes te vetdeklarimit eshte deklaruar se mjeteve eshte marre me qera.

Ne lidhje me kete mjet konstatohet se mjeteve është per perdorim vetiak ne pronesi te shoqërisë KUPA shpk, dhe përdorimi i tij nga persona të tretë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit dhe konkretisht nga shoqëria “Gjelberimi 2000” shpk i cili e deklaroi me qera do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituar të Kodit Rrugor të RSh-së dhe të ligjit “Për Transportin Rrugor”.

Në vijimesi te këtij gjykimi Komisioni i vlerësimit të ofertave vlerëson se mjeteve nuk është paraqitur konform kërkesës së Autoritetit kontraktor dhe nu mund të konsiderohet i rregullt.

Në tërësinë e verifikimit të mjeteve te deklaruara referuar informacionit te disponuar konstatohet se se Bashkimi i operatorëve ekonomik “Gjelberimi 2000” shpk & “I.D.K- Konstruksion” shpk nuk ploteson kriterin percaktuar sipas pikes 2.3.9 për pikën 1 “*Kamionçinë me vinç, masa maksimale jo me shume 3.5 ton*” pasi asnjë nga mjetet e deklaruara ne plotësim të këtij kriteri nuk është i rregullt

Sa më sipër Komisioni i vlerësimit te ofertave gjykon se Bashkimi i operatorëve ekonomik “Gjelberimi 2000” shpk & “I.D.K- Konstruksion” shpk nuk e përmbush kriterin e percaktuar nga autoriteti Kontraktor ne dokumentat e tenderit Kriteret e Vecanta për kualifikim, Kapaciteti teknik, pika 2.3.9 pasi ka patur probleme në përputhje të skedës teknike me deklaratat e bëra si dhe me



përdorimin e ligjshëm të disa prej tyre, duke përjashtuar kështu mundësinë për t'u konsideruar të rregullta nga Komisioni i vlerësimit të ofertave.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se bashkimi i operatorëve ekonomik “Gjelberimi 2000” shpk & “I.D.K-Konstruksion” shpk nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

### **3. “FLORAL” Shpk**

**NIPT-t : L21513012D**

Vlera e ofertës: **57.775.000** (pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë pa Tvsh

***arsyet e mëposhtme:***

**a) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”,pika 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2.1, përcaktohet se:**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa vlera e fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur ne spe nga operatori ekonomik “Floral” shpk operatori ekonomik ka paraqitur vertetimin e xhiros vjetore lëshuar nga drejtoria rajonale e tatimeve Lezhe por nga vertetimi i xhiros konstatohet se vlera e xhiros per operatorin ekonomik është për vitet respektive si me poshtë:

Viti 2021 në vlerën 17.798.200 leke

Viti 2022 në vlerën 2.478.207 lekë

Viti 2023 në vlerën 324.060

Sa më sipër konstatohet se operatori ekonomik nuk arrin vlerën e xhiros sa vlera e fondit limit ne asnjë vit të periudhes së kërkuar të tre viteve financiare. Vlera e fondit limit të procedurës është 58.333.333 (pesëdhjetë e tetëmilion e treqind e tridhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë Monedha, pa TVSH. Sa më sipër operatori ekonomik nuk plotëson kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti ekonomik dhe financiar pika 2.2.1.

**b) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”,pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.2, përcaktohet se:**

**2.3.2** Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se **25 (njëzet e pesë) punonjës** për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a. Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës..

b. Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

*Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.*

Nga verifikimi i formularit përmbledhes të vetdeklarimit konstatohet se operatori ekonomik nuk ka deklaruar nese disponon punonjës ose jo dhe gjithashtu nuk ka deklaruar as numrin e punonjësve në formularin përmbledhës të vetdeklarimit duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.2

**c) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”,pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.3, përcaktohet se:**

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e punonjësve të specializuar te pasqyruar në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, punonjës me profesionet si mëposhtë:

- 3(tre) punonjës Automakinistë. Për këto punonjës duhet të paraqitet leje drejtimi (*e vlefshme*), dëshmi e aftësisë profesionale/patente manovrimi e leshuar nga “Drejtoria e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor” (*e vlefshme*), librezë pune, kontratë pune (*e vlefshme*) dhe dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik te leshuar nga IQT/ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të (*e vlefshme*).

- 1 (një) punonjës që disponon certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, shoqëruar me dokumentacionin diplomë/certifikatë, librezë pune dhe kontratë pune (*e vlefshme*).

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës " Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").

- 6 (gjashtë) punonjës të trajnuar me kurse të trajnimit profesional për ” Punime në fidanishte ” që vërtetohen me paraqitjen e certifikatave/diplomave (*e vlefshme*), te cilat duhet te jene te leshuara nga institucione publike/private te licensuara, për kurset e ofruara, sipas ligjit Nr. 15/2017 “ Per arsimin dhe formimin profesional ne Republikën Shqipërisë” shoqëruar me dokumentacionin librezë pune dhe kontratë pune (*e vlefshme*).

Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sa më sipër sipas formatit te meposhtem:

Tab 1

Emer Mbiemer i punonjesit dhe nr identifikimi	Profesioni	Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Nr NIPT (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)

*Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit si dhe me plotësimin e formatit të deklarates sipas Tab 1.*

*Dokumentacioni provues, për kriterin percaktuar sipas pikës 2.3.2, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Nga verifikimi i formularit përmbledhes të vetdeklarimit konstatohet se operatori ekonomik nuk ka deklaruar stafin e punonjësve të specializuar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit dhe gjithashtu nuk ka plotësuar të dhenat për stafin sipas Tab.1 duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.3.

**d) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.4, përcaktohet se:**

**2.3.4** Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik inxhinier pyjesh i cili duhet të jetë i punësuar pranë operatorit

ekonomik me kohe të plotë pune dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera me qëllim që të ndjekë procesin e mirëmbajtjes dhe dorëzimit të bimësisë dekorative tek Autoriteti kontraktor. Për inxhinierin e pyjeve duhet të paraqitet dokumentacioni provues, Kontratë pune e vlefshme (përkatëse), diplomë, librezë pune, cv.

*(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik).*

*Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për kriterin përcaktuar sipas pikës 2.3.2, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se operatori ekonomik nuk ka deklaruar drejtuesin teknik në formularin përmbledhës të vetdeklarimit dhe gjithashtu nuk ka plotësuar deklaratën se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.4.

**e) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.5, përcaktohet se:**

**2.3.5** Operatori ekonomik ofertues të ketë pjesë të stafit të paktën 1 (një) agronom të lartë, të vertetuar me diplomë, kontratë pune (të vlefshme), librezë pune, cv dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

*Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për kriterin përcaktuar sipas pikës 2.3.2, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se operatori ekonomik nuk ka deklaruar punonjës agronom në formularin përmbledhës të vetdeklarimit duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.5.

**f) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.6, përcaktohet se:**

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon ambient mbështetës të specializuar për të magazinuar bimët (fidanishte) me sipërfaqe mbi 5.000 (mijë) m<sup>2</sup>, me kushte optimale të furnizimit me ujë dhe plehërimit për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet paraqes dokumentacionin që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen:

Dokumentacioni që vërteton pronësinë: *Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / kontrata e shitblerjes / kontrata e dhurimit / çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*

Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen: *Kontratë huapërdorje*.

Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira: *Kontratë qiraje*.

Foto të ambjentit të magazinimit të bimëve (fidanishte).

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të mirëmbaje në fidanishte bimët me kushte optimale të furnizimit me ujë, plehërimin për bimët deri në momentin e dorëzimit tek autoriteti kontraktor sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

Konstatohet se në lidhje me ambjentin mbështetës të specializuar për të magazinuar bimët operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin provues duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.6.

**g) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1, germa “b”, përcaktohet se:**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:** *b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; perkatesisht në vlerën 1.166.666,66 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë dhe monedhën euro sipas kursit të këmbimit datë 21.08.2024 është 11.708,81 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetë presje tetëdhjetë e një) euro.*

Kursi zyrtar i këmbimit për monedhën euro sipas Bankes të Shqipërisë datë 21.08.2024 është 99.64 lek.

Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin e prokurimit elektronik konstatohet se operatori ekonomik nuk ka sjellë *Sigurimin e Ofertës* duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, Pika 1, germa “b”.

**h) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.7, përcaktohet se:**

**2.3.7** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi:

- Çertifikate zyrtare model 3, te aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit, sipas modelit 4, të aneksit 4 dhe certifikate origjinë të leshuara nga Enti Shtetëror i farnave e fidanave sipas VKM Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative) *ose* Operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë furnizimi me një subjekt që duhet të jetë i pajisur me Çertifikate zyrtare model 3 te aneksi 4, autorizim për nxjerrjen dhe lëshimin e etiketave të furnizuesit sipas modelit 4 te aneksit 4 dhe certifikate origjinë të leshuara nga Enti Shtetëror i farnave e fidanave sipas VKM vendim Nr. 523, datë 13.7.2016 për përcaktimin e kriterëve të tregëtimit e certifikimit të materialeve të shumëzimit dhe të fidanëve të bimëve zbukuruese (dekorative)

ose

- Në rastin kur furnizimi do të bëhet nga një prodhues jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë operatori ekonomik duhet të paraqesë një autorizim prodhuesi/distributori për furnizimin nga subjekti importues ku duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, shoqëruar me një deklaratë (nga subjekti importues) që në momentin e furnizimit me druret dhe shkurret dekorative (sipas sasise dhe specifikimeve teknike ) do shoqërohen me “ Çertifikate Fitosanitare “ nga shteti importues , e cila verteton pastertine gjenetike të bimes .

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur deshmi të testimeve zyrtare të kryera për mallrat objekt prokurimi të leshuara nga institucione të autorizuar ose nga prodhuesi duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.7.

**i) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”,pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.8, përcaktohet se:**

**2.3.8** Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloge ose broshura për mallin që oferton duke shënuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme secilin nga artikujt e kuotuar sipas modelit të deklaruar dhe specifikimet sipas shtojces 5 sipas të dhënave në DST. (Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të modelit të kuotuar do të krahasohen me katalogun e pajisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmerinë e tyre).(Pjesa e katalogut që përfshin specifikimet teknike të jete e perkthyer).

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur katalogë për mallrat objekt prokurimi të cilat do ofertojë duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.8.

**j) Në dokumentat e tenderit shtojca 12 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”,pika 2.3 Kapaciteti teknik, pika 2.3.9, përcaktohet se:**

**2.3.9** Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Nr</i>	<i>Lloji i Makinerive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Sasia</i>
1	<i>Kamionçinë me vinç, masa maksimale jo më shumë 3.5 ton .</i>	Pronësi ose me qira	2 Copë
2	<i>Kamionçinë , masa maksimale jo më shumë 3.5 ton .</i>	Pronësi ose me qira	3 Copë
3	<i>Kamion me vinç,(kapaciteti mbajtës minimum 6 ton dhe maksimumi 11 ton ) .</i>	Pronësi ose me qira	2 Copë

Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vëndit (e vlefshme).

- Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik ( e vlefshme ), d) siguracion mjete (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).

*\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit konstatohet se operatori ekonomik nuk ka deklaruar mjetet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.9.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

Nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 92 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” si dhe referuar kriterëve të pranimit dhe kualifikimit komisioni i vlerësimit të

ofertave konkludon se operatori ekonomik “Floral” sh.p.k.nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë në përputhje me kriteret e vendosura **duke e shpallur ofertë të pavlefshme.**

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatorët ekonomikë:  
**“A l b G a r d e n” Shpk**, me adresë: Adrese: Rruga e Kavajes, ish Misto Mame, Zona Kadastrale 8240, Tiranë se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **56.400.000** (pesëdhjetë e gjashtëmilion e katërqindmijë) lekë pa Tvsh, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit me adresë: Rruga“Xhezmi Delli”,Godina nr.20, Tiranë,brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi për të lidhur marrëveshjen.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JOX

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_